



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISE
GRAMSH**

Nr. 3081 / prot
/2

Gramsh, më 02/09/2020

Vendim

Nr. 60, dt. 28.08.2020

Për miratimin e kërkesave në vazhdim për subvencionimin e interesave të kredisë me interes të ulët për familjet që kanë aplikuar pranë bashkisë Gramsh.

Këshilli i bashkisë Gramsh, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga drejtoria e shërbimeve publike dhe emergjencë civile "Për miratimin e kërkesave në vazhdim për subvencionimin e interesave të kredisë me interes të ulët për familjet që kanë aplikuar pranë bashkisë Gramsh", bazuar në ligjin nr.22/2018, "Për strehimin social", neni 73, të VKM nr.334, dt.12.06.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore", të VKM nr. 453, dt.03.07.2019, "Për masën e subvencionimit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët me kredi të lehtësuar nga shteti", si dhe, të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", neni 8, pika 2;

V e n d o s i:

- I. Të miratohen listat në vazhdim për subvencionimin e interesave të kredisë me interes të ulët për familjet që kanë aplikuar pranë bashkisë Gramsh si më poshtë:

1. Familja e z. **Rigent Jashar Sinani** me përbërje familjare 3 vetë, struktura e apartamentit 1+1, kufiri maksimal i kredisë që përfiton familja sipas përbërjes familjare, dhe nivelit të të ardhurave neto të jetë **2 580 000** lekë.

- II. Të miratohet Lidhja 3-Formati i listës emërore.
 III. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet kryetari i bashkisë dhe drejtoria e shërbimeve me sipërmarrje, transporteve, strehimit dhe emergjencave civile.
 IV. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Konc.e,Mema

Miratoi G.Lena
Dosja nr. _____
Afati _____

Sekretari i Këshillit të Bashkisë

Endri MEMA



Kryetari i Këshillit të Bashkisë

Greta LENA